



BASHKIA MIRDITË

BULETINI VJETOR 2025

Të nderuar bashkëqytetarë,

Në përmbyllje të këtij viti, dëshirojmë të ndajmë me ju një përmbledhje të shkurtër të punës, angazhimeve dhe sfidave që kanë shoqëruar veprimtarinë tonë.

Gjatë vitit, jemi përpjekur të përmirësojmë infrastrukturën publike, të rrisim shërbimet komunitare dhe të realizojmë projekte që synojnë të bëjnë jetën e qytetarëve tanë më të lehtë.



Bashkëpunimi dhe mbështetja juaj kanë qenë thelbësore në çdo hap të këtij rrugëtimi.

Me besimin se përkushtimi ynë i përbashkët do të kontribuojë në një të ardhme më të mirë, mbetemi të angazhuar për të vijuar punën me përgjegjësi dhe transparencë.

Gëzuar Vitin e Ri 2026!

Mirdita hap dyer të reja bashkëpunimi në Europë – Binjakëzohet me Bashkinë e Pezinokut në Sllovaki.

Më 19 shtator 2025, Bashkia Mirditë u binjakëzua me Komunën e Pezinokut në Sllovaki, duke hapur një kapitull të ri në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ceremonia solemne u zhvillua në qytetin e Pezinokut, ku kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, dhe homologu i tij sllovak, z. Roman Mács, nënshkruan Memorandumin e Binjakëzimit në prani të personaliteteve të larta diplomatike.

Në këtë event morën pjesë Ambasadori i Shqipërisë në Sllovaki, z. Arten Hanku, Ambasadori i Sllovakisë në Shqipëri, z. Albin Otruba, si dhe Presidenti i Rajonit të Bratislavës, z. Juraj Droba.

Ky binjakëzim, i cili u kurorëzua me mbështetjen e Ambasadës sonë në Sllovaki dhe asaj Sllovake në Tiranë, do të sjellë më afër komunitetet e bashkive respektive në promovimin e projekteve të përbashkëta në fusha të ndryshme, përfshirë zhvillimin ekonomik, arsimin, kulturën dhe ruajtjen e traditave folklorike.



Bashkia Mirditë promovon mundësi konkrete për fermerët.

Bujqësia dhe blegtoria mbeten shtylla kyçe të zhvillimit ekonomik lokal. Më 11 tetor 2025, Bashkia Mirditë zhvilloi një takim me fermerë dhe biznese lokale, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhomën e Tregtisë, Industrisë dhe Agrikulturës së Kozencës (Itali) dhe Madeo Group.

Takimi u fokusua në prezantimin e praktikave të suksesshme të arbëreshëve në Itali si modele për fermerët mirditorë.

Kryetari i Bashkisë, z. Albert Melyshi, bëri thirrje për bashkëpunim mes fermerëve, duke theksuar se: “Bujqësia dhe blegtoria kanë qenë gjithmonë ndër shtyllat kryesore të jetesës për familjet mirditore.

Vetëm nëse arrijmë të prodhojmë, do të kemi zhvillim të vërtetë ekonomik.

Ndërkohë, Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, z. Nikolin Jaka, nënvizoi nevojën për shndërrimin e potencialit natyror të Mirditës në prodhim të qëndrueshëm, vlerë të shtuar dhe punësim.

Pjesëmarrja e Konsulles së Nderit të Shqipërisë në Itali, znj. Anna Madeo, njëkohësisht përfaqësuese e Madeo Group, i dha takimit një dimension praktik, përmes prezantimit të mundësive konkrete të bashkëpunimit për fermerët, ndër të cilat: Prodhimi i vajit të ullirit, rritja e derrave dhe përpunimi i mishit, prodhimi i djathit të bardhë, kultivimi i specave dhe produkteve.



Bashkia Mirditë fituese e programit ReLOaD3.

Bashkia Mirditë është shpallur fituese në thirrjen e programit ReLOaD3, një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

ReLOaD3 ka për qëllim të forcojë demokracinë vendore, duke rritur bashkëpunimin midis pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe duke nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Përmes këtij programi, Bashkia Mirditë do të ofrojë mbështetje për organizatat e shoqërisë civile që do të angazhohen në zbatimin e prioritetëve vendore në fushën e promovimit të trashëgimisë kulturore dhe identitetit lokal, mbrojtjen e mjedisit, dhe rinisë.



TIP MIRDITA

Bashkia Mirditë lançoi këtë vit për herë të parë një program mbështetës për të rinjtë, me synimin për t'u dhënë hapësirë ideve të reja dhe nxitjes së sipërmarrjes lokale.

Ky program është krijuar për të mbështetur iniciativa që sjellin risi dhe ndikim pozitiv në jetën komunitare dhe ekonomike të Mirditës.

Thirrja u prit me interes nga shumë të rinj dhe të reja, të cilët paraqitën ide kreative dhe premtuese, ndërsa 13 prej tyre u përzgjodhën për t'u mbështetur në realizimin e projekteve të tyre.



Platforma që fuqizon
të rinjtë & bizneset
në Mirditë

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin turistik Katund i Vjetër.

Bashkia Mirditë është shpallur fituese në thirrjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) “Mekanizmi i nxitjes së kapaciteteve bashkiake për zbatimin e projekteve”.

Projekti i miratuar, “Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin turistik Katund i Vjetër”, synon rritjen e sigurisë dhe aksesueshmërisë, si dhe zhvillimin e turizmit lokal në këtë zonë me potencial të lartë turistik.

Punimet kanë nisur dhe përfshijnë ndërtimin e një korsie të dedikuar për këmbësorët dhe biçikletat, vendosjen e ndriçimit rrugor, si dhe instalimin e sinjalistikës rrugore dhe turistike.

Projekti pritet të përfundojë në vitin 2026.




Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore mbetet një nga sfidat kryesore për Bashkinë Mirditë, për shkak të shtrirjes gjeografike, terrenit të vështirë dhe nevojave të shumta, veçanërisht në zonat rurale.

Gjatë vitit janë ndërmarrë përpjekje për mirëmbajtje dhe ndërhyrje emergjente, ndërkohë që përmirësimi i qëndrueshëm i rrjetit rrugor kërkon investime afatgjata dhe mbështetje të mëtijshme.

Gjatë vitit janë përfunduar disa ndërhyrje të rëndësishme infrastrukturore, si : Asfaltimi i Bllokut nr. 3, Rrëshen; Sistemim dhe asfaltim i segmentit të rrugës Reps, Njësia Administrative Orosh; Riveshje me shtresë asfaltike e rrugës “Rruga e Dijes” dhe një rrugice përreth, Rrëshen; Riveshje me shtresë asfaltike e rrugës në lagjen e mesme, Rubik; Riveshje me shtresë asfaltike e rrugës rreth pallatit 9-katësh “Kullat Jakaj”, Rrëshen; Rikonstruksion i rrugës rreth pallatit 9-katësh “Internacional”, Rrëshen; Sistemim-asfaltim i rrugës Ndërfushaz–Ndërfanë; Sistemim-asfaltim i rrugës së fshatit Jezull.



Rruga e fshatit Ndërfanë



Sistemim - asfaltimi në rrugën kryesore Reps



Rubik



Rrëshen



Rrëshen



Së shpejti – një destinacion i ri turistik në Mirditë.

Bashkia Mirditë po përgatitet të ofrojë një destinacion të ri turistik në zonën malore të Lufajt, falë projektit “Mirdita–Junik – Nxitja e Zhvillimit të Turizmit të Qëndrueshëm Ndërkufitar”, i financuar nga Bashkimi Evropian.


Ky projekt ka për qëllim zhvillimin e turizmit natyror, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe përfshirjen aktive të komuniteteve lokale në aktivitetet turistike.

Si pjesë e tij do të ndërtohet “Future Mind – Panoramic Mountain Trail and Belvedere”, një shteg këmbësor rreth 1.25 km, i integruar me natyrën dhe i ndërtuar me materiale ekologjike.

Gjatë shëtitjes vizitorët do të gjejnë Infopoint me informacion mbi itinerarin, pika pushimi, stacione panoramike dhe një belvedere ikonike me pamje 360° mbi peizazhin malor.

Projekti kombinon natyrën, arkitekturën dhe përvojën ndijore, duke e bërë shëtitjen jo vetëm relaksuese, por edhe edukative.

Ky destinacion i ri do të jetë një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në rajon dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri–Kosovë, duke promovuar Mirditën si një pikë referimi natyrore dhe kulturore për vizitorët vendas dhe të huaj.



Future Mind – Panoramic Mountain Trail and Belvedere, Lufaj.



Future Mind – Panoramic Mountain Trail and Belvedere, Lufaj



Bashkia Mirditë fituese e projektit WiFi4WB.

Bashkia Mirditë është shpallur fituese e projektit WiFi4WB, një nismë e bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë, e zbatuar përmes projektit EU4Digital.

Ky projekt synon të ofrojë akses falas dhe të shpejtë në internet për qytetarët, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve digjitale dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik e social të komunitetit.

Përmes këtij projekti, do të mundësohet vendosja e pikave publike të WiFi-së falas në zona kyçe të qytetit, duke u ardhur në ndihmë të rinjve, bizneseve, institucioneve dhe vizitorëve.



Co-funded by
the European Union



#GrowthPlan

Implemented by



Projekti EFFORT – Investime për përmirësimin e efikasitetit energjetik në Bashkinë Mirditë.

Bashkia Mirditë po zbaton projektin EFFORT, një ndër projektet më të rëndësishme në fushën e efikasitetit energjetik, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Projekti zbatohet në partneritet me Komunën Junik dhe Co-PLAN, dhe synon përmirësimin e efikasitetit të energjisë në Bashkinë Mirditë dhe në Komunën Junik, Kosovë.

Në kuadër të këtij projekti, së shpejti pritet të nisë zbatimi i ndërhyrjeve konkrete në territorin e Bashkisë Mirditë, të cilat përfshijnë instalimin e paneleve fotovoltaike në 7 ndërtesa publike, termoizolimimin e një objekti publik, si dhe vendosjen e një pompe termike në një shkollë në Mirditë.

Këto ndërhyrje synojnë reduktimin e konsumit të energjisë, uljen e kostove operative dhe rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme, duke kontribuar në përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave publike

EFFORT
ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME PËR
ENERGJINË NË MIRDITË DHE JUNIK




Funded by
the European Union

Vijon puna për muzealizimin e Muzeut Historik të Mirditës.

Muzeu Historik i Mirditës është pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore , prandaj vijon puna për t'a kthyer këtë institucion në pikë referimi për vizitorët vendas dhe të huaj.

Në kuadër të një marrëveshje të Bashkisë Mirditë me Muzeun Historik Kombëtar, është siguruar një pjesë e infrastrukturës për muzealizimin.

Gjithashtu është në proces një marrëveshje e Bashkisë Mirditë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Institutin e Arkeologjisë, për të rikthyer një pjesë nga objektet arkeologjike që janë zbuluar gjatë fushatave arkeologjike në vitet '60-'90 në disa zona të Mirditës, të cilat ndodhen në fondin e Institutit të Arkeologjisë.



Mirdita në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit ITB Berlin 2025

Gjatë vitit 2025, Mirdita mori pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit ITB Berlin 2025, një nga eventet më të rëndësishme globale në fushën e turizmit.

Në kuadër të promovimit të Shqipërisë si “Vendi i Nderit”, Mirdita u prezantua si një destinacion me vlera natyrore dhe kulturore, duke theksuar turizmin malor, ecjet në natyrë, fshatrat tradicionale dhe trashëgiminë historike e fetare.

Pjesëmarrja në ITB Berlin 2025 përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për rritjen e vizibilitetit të Mirditës në fushën e turizmit.



Arsimi, kultura dhe aktivitetet komunitare.

Gjatë vitit janë mbështetur një serë aktivitete kulture, arsimore dhe sociale, me qëllim ruajtjen e traditave dhe forcimin e jetës komunitare në territorin e bashkisë Mirditë.

Një rol të rëndësishëm në promovimin e trashëgimisë kulture ka pasur Ansambli Mirdita, i cili ka përfaqësuar zonën përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kulture brenda Mirditës, si dhe në veprimtari jashtë vendit, përfshirë pjesëmarrjen në festën e Komunës San Cosmo Albanese në Itali dhe në disa emisione televizive.

Gjithashtu, Qendrat Kulture të Fëmijëve kanë vijuar funksionimin e tyre, duke ofruar aktivitete edukative, artistike dhe formuese për fëmijët dhe të rinjtë.

Këto qendra kanë kontribuar në zhvillimin e aftësive krijuese, në përfshirjen aktive të fëmijëve në jetën kulture dhe në ruajtjen e vlerave kulture të Mirditës.



Ansambli Mirdita në emisionin Gurra Popullore , diell Top Channel.



QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE

